VENDIM
Nr. 62, datë 27.1.2016

PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROCEDURËS SË THJESHTUAR PËR NDRYSHIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP), TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1, DATË 4.7.2013, TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, "PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17 e 26, pika 3, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të nenit 3, të ligjit nr. 73/2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të pikës 27.1, të nenit 27, dhe të pikës 6/1/b, nënndarja "iii", e pjesës 1, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)", ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP), të miratuar me vendimin nr. 1, datë 4.7.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)".

2. Miratimi i ndryshimeve të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP bëhet sipas procedurave të mëposhtme:

a) Komisioni i Vlerësimit Teknik në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si ministria përgjegjëse për koordinimin në përgatitjen e shtesës së Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP, kryen shqyrtimin teknik të Planit Kombëtar Sektorial, brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të përgatitjes së dokumentit.

b) Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, Komisioni i Vlerësimit Teknik harton raportin e vlerësimit teknik të ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial, të cilin, pas miratimit të ministrit, ia përcjell sekretariatit teknik të KKT-së dhe e boton vendimin në regjistër.

3. Procedurat e thjeshtuara për përgatitjen dhe shqyrtimin e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP) kanë për qëllim të shkurtojnë afatet e procesit të hartimit dhe konsultimit të dokumenteve respektive të planifikimit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, si dhe të përfshijnë çështje që nuk prekin qëllimet e përmbajtjen e këtij plani dhe nuk cenojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore në zonat ku do të bëhen ndryshimet e PKS-së për projektin TAP.

4. Përgatitja e ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP bëhet nën koordinimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si ministria përgjegjëse për sektorin energjetik, e cila përgatit planin e veprimit dhe grafikun kohor, bën vlerësimin e kompletimin e dokumentacionit të ndryshimit të PKS-së për projektin TAP, mbi bazën e materialit "Të dhëna për një ndryshim në Planin Kombëtar Sektorial të Projektit TAP" e të materialit grafik përkatës, të paraqitura nga TAP AG, si dhe siguron një proces konsultimi me palët e interesuara përpara fillimit dhe gjatë hartimit të dokumentit të ndryshimit të PKS-së.

5. Gjatë hartimit të ndryshimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP, dokumenti duhet të konsultohet me AKPT-në, e cila mbështet procesin, duke verifikuar përputhshmërinë me instrumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama